



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2534, datë 15.01.2015

Për

**Shqyrtimin e ankimit administrativ të subjektit “Vraniger Communications”
sh.p.k kundër gjobës nr. 14, datë 11.11.2014.”.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj Alketa	Mukavelati	Anëtare
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Znj.M.Drushku, në mbledhjen e datës 15.01.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“ Shqyrtimin e ankimit administrativ të subjektit “Vraniger Communications”
sh.p.k kundër gjobës nr. 14, datë 11.11.2014.”.**

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 136 e vijues i ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” i ndryshuar (**ligji nr. 8485**);
3. Ligji nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

4. Rregullore e AKEP nr.1516 datë 31.01.2011 “Për Inspektimin e veprimtarisë në fushën e komunikimeve elektronike dhe kundravajtjet administrative”;

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Ankim Administrativ të subjektit “**Vraniger Communications**” sh.p.k (AKEP: nr.2309/5 prot, datë 09.12.2014), me objekt shfuqizimin e gjobës nr. 14 datë 11.11.2014;
2. Dosje-dokumentare e Grupit të Inspektimit në zbatim të Urdhërit të Inspektimit Nr.prot 2303 datë 21.10.2014 e cila përfshin (Akt –Inspektimi nr.prot 2309/2 datë 13.11.2014, Njoftim për Aktin e Inspektimit nr.prot 2309/4 datë 13.11.2014, Gjobë nr. 14 datë 11.11.2014 me nr. serie 0005 kundrejt subjektit “Vraniger Communications” sh.p.k, korrespondencë ndërmjet palëve);
3. Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (*Relacioni*);
si dhe duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

I.

Subjekti “**Vraniger Communications**”sh.p.k me anë të shkresës (AKEP: nr.2309/5 prot, datë 09.12.2014), Ankim Administrativ drejtuar Këshillit Drejtues të AKEP ka kërkuar shfuqizimin e Gjobës nr. 14 datë 11.11.2014 duke paraqitur pretendimet e tij lidhur me këtë pikë.

Subjekti “*Vraniger Communications*” sh.p.k me shkresën (AKEP: nr.2309/5 prot, datë 09.12.2014), Ankim Administrativ, konstaton se Gjoha e vendosur nga Grupi i Inspektimit me nr. 14 datë 11.11.2014 është e pavlefshme dhe kërkon nga Këshilli Drejtues i AKEP shfuqizimin e saj, pasi sipas tij:

- Subjektit Vraniger Communications”sh.p.k nuk i janë paraqitur asnjehere faturat e korrigjuara nga AKEP pas vendimit të Gjykatës së Apelit.
- Çështja e faturave të vjetra dhe gjobës nuk është diskutuar gjatë procesit të inspektimit.

- Përpara caktimit të masës së gjobes Grupi i Inspektimit nuk i ka kërkuar takim për sqarime në lidhje me gjobën.
- Çështja është në gjykim në Gjykatën e Lartë Tiranë.

Në parashtrimet e tij ankimesi shpjegon :

Më datën 22.10.2014 subjekti “Vraniger Communications” sh.p.k është kontaktuar me *e-mail* nga Z.L.Kokthi anëtar i grupit të inspektimit të AKEP për kryerjen e një inspektimi në subjektin Vraniger Communications shpk.

Grupi i inspektimit në datën 22.10.2014 kishte vajtur në objektin ku ndodhej centrali kryesor në komunën Pojan të Korçës, por nuk kishin gjetur asnjë punonjes, pasi personi i caktuar nuk ndodhej për arsye fatkeqësie.

Me email nga Z.E.Pina, është njoftuar për paraqitje në ambientet e AKEP më datë 31.10.2014, dhe si rrjedhojë në përgjigje të kërkesës subjekti pretendon se është paraqitur në AKEP.

Nga Grupi i Inspektimit është kërkuar të paraqesë disa dokumente, duke dhënë sqarime dhe shpjegime.

Subjekti pretendon se në takim nuk është shtruar çështja e pagesave të faturave të sipërcituara dhe në asnjë moment nuk i është thënë se do të ndeshkohej me gjobë.

Pas përfundimit të takimit me Grupin e Inspektimit subjekti pretendon se është kërkuar me email që deri në datën 05.11.2014 të ishte prezent pasi nga Grupi i Inspektimit do të kryhej inspektim në ambientet e kompanisë Vraniger sh.p.k.

Për të përmbushur detyrimin ligjor subjekti ka qëndruar në pritje të Grupit të Inspektimit deri më datë 05.11.2014, por në adresën zyrtare të kompanisë Vraniger sh.p.k nuk u paraqit për asnjë moment Grupi i Inspektimit.

Me datën 06.11.2014 në ambientet e AKEP është dërguar nga kompania Vraniger përfaqësues të cilit i janë kërkuar dokumenta shtesë.

Me email datë 7.11.2014 i janë kërkuar dokumenta shtesë dhe ndërkohë subjekti ishte impenjuar në përgatitjen e tyre.

Në datë 02.12.2014 subjekti “Vraniger Communications”sh.p.k gjen në kutinë postare shkresën e AKEP dhe dokumentat e sipërcituara.

Faturat nr. serial 0003242 datë 27.07.2009 dhe nr. serial 0000983 datë 03.11.2010 kanë qenë dhe janë objekt Gjykimi mes Vraniger dhe AKEP.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë Subjekti ka fituar Gjyqin.

Më tej çështja është ankimuar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë e cila la pjesërisht në fuqi Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe si rrjedhojë subjekti ka qenë në pritje të korigjimit të faturave.

Vendimi i sipërpërmendur është ankimuar në Gjykatën e Lartë nga Subjekti dhe është në pritje për tu shqyrtuar.

Subjekti nuk mund të paguante pa e ditur vlerën që duhet të paguante. Konstaton gjithashtu se gjoba nr.14 është vendosur më datë 11.11.2014 ndërsa akti i inspektimit është mbajtur më datë 13.11.2014 duke e konsideruar si paragjykim dhe paraveprim për gjobitje.

Subjekti “Vraniger Communications”sh.p.k. lidhur me sa më lart, shprehet se nuk është dakord me gjobën dhe i kërkon AKEP-it shfuqizimin e saj.

Sa më sipër AKEP, Vëren se,

Grupi i Inspektimit në zbatim të Urdhërit të Inspektimit nr.2303 prot date 21.10.2014 si dhe në përputhje ligjin nr. 9918 date 19.05.2008, i ndryshuar “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Rregulloren e AKEP nr.1516 datë 31.01.2011 “Për Inspektimin e veprimtarisë në fushën e komunikimeve elektronike dhe kundravajtjet administrative”, u paraqit pranë ambienteve të Subjektit “Vraniger Communications”sh.p.k, për kryerjen e inspektimit me tematikë të përcaktuar në Urdhërin e Inspektimit sipërcituar më datë 22.10.2014 ora 10:00.

Grupi i Inspektimit do të kryente verifikimin faktik të detyrimeve sipas pikave të tematikës dhe do të priste nga subjekti paraqitjen e dokumentave të kërkuara.

Grupi i Inspektimit në përputhje me nenin 18 “Procedurat e Inspektimit”, u paraqit pranë ambienteve të subjektit “Vraniger Communications”sh.p.k, por nuk u prit nga asnjë përfaqesues i sipërmarrësit për kryerjen e inspektimit.

Në ambientet e jashtme të sipërmarrësit u konstatuan këto paisje në gjëndje pune:

Rocket M5

Air Grid.

Grupi i Inspektimit siguroi keto prova:

Procesverbali i datës 22.09.2014 i nënshkruar nga Grupi i Inspektimit.

Fotografimi i ambienteve të jashtme të sipërmarrësit të komunikimeve elektronike “Vraniger Communications”sh.p.k, konstatimi i këtyre paisjeve në gjëndje pune në frekuencën 5.8 GHz.

Rocket M5

Air Grid.

Fotot e subjektit “Vraniger Communications”sh.p.k, nënshkruar nga dy palët.

Detyrimet në AKEP (referuar faturave të AKEP me nr. serie 0003242 date 27.7.2009 dhe nr. serie 0000983 datë 03.11.2010).

Duke marrë parasysh sa më lart, nga analiza e Dosjes së Praktikes Inspektuese , Aktit të Inspektimit dhe korrespondencës midis Grupit të Inspektimit dhe Perfaqësuesit Ligjor të “Vraniger Communications” shpk Z.Gerond Sevrani konstatohet se:

Ankimuesi “Vraniger Communication” shpk nuk ka treguar seriozitetin e duhur në marrëdhëniet me Grupin e Inspektimit të AKEP-it, nuk ka siguruar pritjen dhe shoqërimin e tyre në ambientet e tij dhe me justifikime të pabazuara ju ka vështirësuar inspektorëve kryerjen e Inspektimit.

Kjo vertetohet nga korrespondenca e këtij subjekti me Grupin e Inspektimit ku pretendohet për pamundësinë e përfaqësuesit ligjor Z.Gerond Sevrani për mos prezencë të tij gjatë kryerjes së inspektimit për shkak të obligimeve zyrtare jashtë vendit.

Ankimuesi pretendon se i janë kërkuar dokumenta shtesë dhe se po merrej me përgatitjen e tyre.

Nga kqyrja e korrespondencës rezulton se nga Grupi Inspektimit nuk është kërkuar asnjë dokument tjetër përveç atyre të përcaktuara në Urdhërin e Inspektimit dhe për këtë subjekti është sqaruar me email-in e datës 07.11.2014 dërguar Z.Gerond Sevrani nga Kryetari i Grupit të Inspektimit, Z.Ermir Pina.

Grupi Inspektimit ka vepruar konform Rregullores “Për inspektimin e veprimtarisë në fushën e komunikimeve elektronike dhe kundravajtjet administrative” miratuar me VKD Nr.1516, datë 31.01.2011 si dhe legjislacionit në fuqi. Veprimet e kryera, konstatimet, provat dhe shpjegimet, konkluzionet, janë të mbështetura plotësisht në ligje e fakte .

Ankimuesi nuk ka paraqitur asnjë ankesë për inspektimin brenda afatit prej 48 orësh që parashikon Rregullorja për shkeljet që pretendon se janë kryer nga Grupi Inspektimit.

Në lidhje me Vendimin e Grupit të Inspektimit për vendosjen e gjobës në vlerën e 300 000 (treqind mijë) lekë për mos zbatimin e nenit 77 “Pagesat për Përdorimin e Frekuencave”, në mbështetje të nenit 139 “Gjobat” të ligjit Nr.9918/2008, i ndryshuar Ankimuesi pretendon se Faturat nr.serial 0003242, date 27.07.2009 dhe nr.serial 0000983, datë 03.11.2010 janë objekt gjykimi mes Vraniger dhe AKEP, aktualisht është kryer Rekurs në Gjykatën e Lartë dhe se subjekti është në pritje të Vendimit sqarojmë :

AKEP ka njoftim për ankimimin nga ana e subjektit “Vraniger Comunicaton” sh.p.k në Gjykatën e Lartë kundër Vendimit të Gjykatës së Apelit, panvarësisht këtij ankimimi perligjet tagri i AKEP për të ushtruar kompetencën e tij për vendosjen e gjobës për mos shlyerjen e detyrimeve që ky subjekt ka sipas faturave të sipërcituara.

Gjithashtu rezulton se nga ana e AKEP është respektuar Vendimi i Gjykatës së Apelit nr.1826 datë 10.07.2012 për korrigjimin e faturave.

Për pretendimin nga ana e subjektit se gjoba nr.14 është vendosur në datën 11.11.2014 ndërsa Akti i Inspektimit është mbajtur në datën 13.11.2014 , ndërkohë që duhej të ishin mbajtur në të njëjtën ditë, konsideruar si paragjykim dhe paraveprim për gjobitje, AKEP sqaron se :

Akti Inspektimit dhe Gjoba nr.14 janë mbajtur në datën 11.11.2014 dhe është regjistruar Nr.2309/2 Prot, datë 13.11.2014. Kjo vërtetohet nga dokumenti Akt- Inspektimi regjistruar me Nr.2309/2 Prot.date 13.11.2014. Ankimuesi ka ngatërruar datën e mbajtjes së Aktit Inspektimit me datën e regjistrimit të tij.

Si përfundim, Gjoba nr. 14 është vendosur më datë 11.11.2014, ndërsa Ankimi Administrativ nga ankimuesi Vraniger Communications është kryer në datën 04.12.2014.

Në mbështetje të nenit 136 të Ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kundër gjobës së vendosur sipas këtij neni të ligjit bëhet ankim në Këshillin Drejtues të AKEP brenda 10 ditëve nga data e dhënies së saj, si dhe nenit 26 pika 26.2 Ankimi ndaj gjobave, të Rregullores së AKEP nr.1516, datë 31.01.2011 “Për Inspektimin e veprimtarisë në fushën e komunikimeve elektronike dhe kundravajtjet administrative”.

Ankimi Administrativ ndaj gjobës duhet të kryhet nga subjekti brenda 10 ditëve nga data e dhënies së saj, nga dokumentacioni i paraqitur nga Subjekti Vraniger Communications”sh.p.k, vihet re tejkalim i afateve te ankimit.

Në mbështetje të Nenit 136 Ankimi të Ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 26, pika 26.2 Ankimi ndaj gjobave te Rregullores së AKEP nr.1516 datë 31.01.2011 “Për Inspektimin e veprimtarisë në fushën e komunikimeve elektronike dhe kundravajtjet administrative”, Ankimi Administrativ i subjektit “Vraninger Communication” shpk për shfuqizimin e gjobës nr.14, datë 11.11.2014 nuk është depozituar ne respektimin e afatit 10 ligjor të lejuar për paraqitjen e ankesës në Këshillin Drejtues të AKEP-it.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 144/b) dhe 146, të Kodit të Procedurave Administrative,

V E N D O S:

1. Mos pranimin e Ankimit Administrativ të subjektit “Vraninger Communication” shpk për shfuqizimin e gjobës nr.14, datë 11.11.2014 për mosrespektimin e afatit 10 ditor për paraqitjen e ankesës në Këshillin Drejtues të AKEP-it;

2. Të njoftohet Vraninger Communication sh.a. për zbatimin e këtij Vendimi;
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Tiranës, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij vendimi.
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Alketa MUKAVELATI**
3. **Benon PALOKA**
4. **Zamira NURÇE**